## AKT THEMELIMI
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## "EUROKONTAKT" SH.P.K TIRANE

Sot me date 15.05.2003, une i nenshkruari GENT PRIZRENI, i biri i Namikut, i datelindjes 17.01.1976, i lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane me adrese: Rruga Ali Demi Pall.2, me leternjoftim 0250328, mbeshtetur ne dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi ne fushen e prones private dhe te shoqerive tregetare, me deshiren time te plote dhe vullnetin tim te lire, vendos te merrem me aktivitet privat duke themeluar shoqerine si me poshte:

**Neni 1**

Une, personi fizik i siperpermendur, me vullnetin time te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar, vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuat (sh.p.k) me emertimin "EUROKONTAKT" sh.p.k.

Kjo shoqeri tregetare eshte prone vetem e imja.

Une GENT PRIZRENI jam ortak i vetem i saj.

Mua me perkasin te gjitha te ardhurat dhe fitimet qe do te rezultojne nga aktiviteti i saj.

Shoqeria do te kete seline e saj ne kete adrese:

Rr. "Luigj Gurakuqi" Nr.7 Tirane

Shoqeria "EUROKONTAKT" sh.p.k ka te drejte te krijoje filialet e saj Brenda dhe jashte vendit, ne çdo kohe qe te çmohet e nevojshme dhe e arsyeshme prej ortakut te vetem dhe me miratim te organeve kompetente.

Administrator i shoqerise eshte ortaku i vetem Gent PRIZRENI.

**Neni 2**

Shoqeria "EUROKONTAKT" sh.p.k Tirane eshte person juridik shqiptar.

Ajo do te zhvilloje veprimtarine sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkengjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te zhvilloje aktivitet per nje periudhe kohe te panderprere prej 10 vjet.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, nese ortaku i vetem me vullnetin e tij te lire nuk e zgjat kete afat.

Ajo mund te mbyllet edhe perpara ketij afati, me urdherin e vendimin te Ortakut te Vetem.

**Neni 4**

Shoqeria "EUROKONTAKT" sh.p.k Tirane do te kete kryesisht kete objekt te aktivitetit te saj:

*Tregetim pajisje dixhitale profesionale per radio dhe televizione, komunikacion dhe sisteme kondicionimi, informatike dhe rrjete komjuterash.*

**Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Ky kapital depozitohet ne emer te "EUROKONTAKT" sh.p.k Tirane, prej ortakut te vetem GENT PRIZRENI

**Neni 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie do te administrohet nga Ortaku i Vetem Gent PRIZRENI

**Neni 7**

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Ortaku i Vetem nuk mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tij qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

**Neni 8**

Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortak nje person tjeter, pa pelqimin e Ortakut te Vetem.

**Neni 9**

Ortaku i Vetem dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin kofidencial te aktivitetit te shoqerise.

Cilido qofte qe shkel detyrimin e mesiperm dhe nga kjo shkelje shoqerise i shkaktohet nje dem, eshte i detyruar te shperbleje demin.

**Neni 10**

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes

**Neni 11**

Mosmarreveshjet e mundeshme qe shoqeria do te kete me te tretet apo Brenda perbrenda saj, ne rast se nuk do te mund t'i zgjidhe me mirekuptim, do t'i zgjidhe ne gjykaten e rrethit.

**Neni 12**

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Ortaku i vetem pasi e lexoi me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjeti ate konform vullnetit te tij, nenshkruan rregullisht.

**ORTAKU I VETEM**

**GENT PRIZRENI**

Gent Prizreni